

VENDIM
Nr. 120, datë 17.7.2020

**MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, PËR LICENCIM NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/3 prot., datë 13.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13, datë 23.1.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. , në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimarrjeje, ERE, me shkresën nr. 62/2 prot., datë 24.1.2020, ka kryer njoftimin në median e shkruar. Me shkresën nr. 291 prot., datë 28.1.2020, ka përcjellë pranë shoqërisë “Albpetrol” sh.a. njoftimin për vendimin e fillimit të procedurës dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në lidhje me dokumentacionin e munguar, të konstatuar në dosjen e aplikimit dhe nevojën për informacion shtesë.

- Në seancën e caktuar në datën 7.2.2020, nuk u paraqit asnjë nga përfaqësuesit e “Albpetrol” sh.a. , ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 291/1 prot., datë 12.2.2020, duke i rikujtuar kërkesën për plotësim dokumentacioni apo dhënien e informacionit shtesë në lidhje me aplikimin e “Albpetrol” sh.a.

- Në vijim, me shkresën protokolluar në ERE nr. 291/2 prot., datë 2.3.2020, shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar në aplikimin për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për shkak se shoqëria është në proces ristrukturimi dhe nga ky ristrukturim janë prekur punonjës të cilët e kishin për detyrë të merreshin me plotësimin e këtij dokumentacioni. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. thekson se e ka të domosdoshme pajisjen me këtë licencë, duke qenë se në objektin e veprimtarisë së saj ka kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 291/5 prot., datë 1.7.2020, me anë të së cilës i ka kërkuar marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të depozituar brenda datës 6.7.2020, të gjithë dokumentacionin e munguar, në plotësim të kërkesave të sipërcituara të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. me shkresën nr. 3799 prot., datë 6.7.2020, protokolluar në ERE me nr. 291/6, datë 6.7.2020, ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e vendimarrjes së Bordit mbi këtë licencim.

- Për shkak të situatës së krijuar nga COVID -19, vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe masave që u morën në vijim të udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për parandalimin e përhapjes së COVID-19, shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka punuar me staf të reduktuar, orar të reduktuar dhe nga shtëpia. Kjo situatë ka çuar në vështirësi në lidhje me koordinimin dhe përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar nga ERE në kuadër të licencimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. kërkon nga ERE shtyrjen me 3–6 muaj të afatit për plotësimin e dokumentacionit të munguar, pasi shoqëria e ka të domosdoshme pajisjen me licencën e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), duke qenë se në objektin e veprimtarisë së saj ka kryerjen e operacioneve hidrokarbure, në përputhje me ligjin nr. 7746, datë 20.8.1993 “Për hidrokarburet”, të ndryshuar.

- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të vendimit të Bordit është depozituar në afat dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, ERE vlerëson se kërkesa e shoqërisë është e arsyeshme dhe e bazuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për zgjatjen e afatit të procedurës administrative, për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, deri në datën 6.1.2021.

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar jo më vonë se data 31.12.2020.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti